



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE VLORË

**NOTER FLORA XH. ZOTO
ADRESA 29 NENTORI, DERVISH
HEKALI, P.4 KATESH PRANE
GJYKATES
TEL: 695225897**

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

(VËRETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

Nr. repertori: 695

Fier më 24/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notcrinë"




V2021062240037615953

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER FLORA XH. ZOTO**



V2021062240037615953



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 24.02.2021, para meje Notere FLORA XH. ZOTO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERVISH HEKALI, P.4 KATESH PRANE GJYKATES, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Pamela Gremi, atësia Zenel, amësia Yllka, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në Patos, me adresë Beline; Nd. 105; H. 0; Ap. 0; Zharëz; Belinë; 9317; Patos, lindur më 11/08/1995, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032250037 dhe nr. personal J55811019V , .

NËNSHKRUES:

Era Çuko, atësia Bajram, amësia Gjyljana, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë Rrapi Shkurti Raj.2 Fier; Nd. 1; H. 0; Ap. 0; Fier; Fier; 9305; Fier, lindur më 25/03/1994, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032160965 dhe nr. personal J45325098I , .

Shtetaset e mesiperme , në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Aktin e themelimit te shoqerise Medical -Sal, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

FLORA XH. ZOTO

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ **Medikal –Sal** “ shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare sot me date 24.02.2021 me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin“**Medikal –Sal** “ shpk

KREUI

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**Medikal –Sal** “SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “**Medikal –Sal** “ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga nga ortakut i vetem, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Fier ,Sheqishte , zona kadastrale 3361 , numer pasurie 94/22 .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria “**Medikal –Sal** ” shpk., ka per objekt kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar me ligj dhe/ ose pjesemarrjine ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe, ne vecanti :

Tregetim me shumice dhe pakice , import eksport me shumice dhe pakice solucionesh higjenike ,materiale dentare .

Prodhim dhe tregtim me shumice e pakice e materialeve te ndertimit, produkteve qeramike,

dekorative, shfrytezim dhe perpunimi i produkteve minerale te grupit I-IV

Tregtim me shumice dhe pakice i mallrave industriale, makinerive, pajisjeve dhe pjese kembimi te ndryshme, import eksport i mallrave, makinerive, pajisjeve dhe materiale ndertimi, te pajisjeve hidraulike dhe elektrike, tregtim i pajisjeve te ndryshme elektroshtepiake, elektronike, hidrosanitare, qeramike dhe te artizanatit.

Import eksport me shumice dhe pakice te sistemeve te kondicionim ventimilit, te sistemeve te ngrohjes, kaldajave etj.

Prodhim dhe tregtim te artikujve te ndryshem mobilierie, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregtim paisje zyre, kanceleri, paisje ventilimi dhe kondicionimi, kundra zjarrit.

Pastrim kimik

Agjensi udhetimesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.

Import eksport dhe tregtim me shumice e pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to.

Import, eksport, tregtim te pajisjeve dixhitale, radiotelevizive, informatike, komunikacion, industriale, elektrike.

Import eksport, tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqesor dhe blegtorale, paisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, metrazhe, lende kimike.

Grumbullim, perpunim, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te bimeve medicinale, produkteve dhe nenprodukteve bujqesore, blegtorale dhe pyjore.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga " asambleja e ortakeve te shoqerise

Ortaku Themelues: Era Cuko, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 50 Leke, qe perbene 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaku Themelues: Pamela Gremi, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 50 Leke, qe perbene 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do të ngurtesohet në Banke pasi të dali NIPTI i shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te paktën tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë “**MEDIKAL –SAL** “ shpk është znj. Era Cuko , atesia Bajram , e datelindjes 25.03.1994 , lindur në Fier e banues në Fier, shtetas shqiptar, me Nr Personal: J453250981 e cila do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetore me të drejta ripërteritje dhe Pamela Gremi , atesia Zenel , e datelindjes 11.08.1995 , lindur në Fier e banuese në Fier , shtetase shqiptare me numer personal J55811019V e cila do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetore me të drejta ripërteritje

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Ortakëve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratorët kanë të drejta dhe detyrohen të dy bashkë :

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së ortakëve edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "MEDIKAL-SAL " shpk, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Era Cuko

ERA ÇUKO


Pamela Gremi

Pamela Gremi
